



REPUBLIKA E KOSOVËS
/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/

GJYKATHEMELORE NË MITROVICË /OSNOVNI SUD U MITROVICI/BASIC COURT IN MITROVICA

C.nr. 30/2010

GJYKATA THEMFLORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshijen juridike te paditesit; nga Shipoli Komuna e Mitrovices, kunder te paditures; [M .lindur] nga Shipoli-Komuna e Mitrovices, tani me vendim te panjohur te cilin e perfaqson perfaqsesi i perkohshem; Avokat nga Mitrovica, sipas aktvendimit te kesaje gjykate , baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e kontestit; 500,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.16.04.2013, jep ket.;

A K T G J Y K I M

- **APROVOHET** kerkespadia e paditesit; **Mustafe Ademi** nga Komuna e Mitrovices dhe **VERTETOHET** se paditesi eshte pronar i parc. kat. 274 /4 me kultur oborr me siperfaqe S= 0.04.00 ha, ne vendin e qujtur "Fshati-nder rruge" e evidentuar sipas qertifikates se pronesise nr. 73 ZK- Shipol e cila udhehiqet ne emer te paditures; [M. Lind.]

-**Detyrohet** e paditura qe ti njoh kete te drejte paditesit dhe te lejoje qe paditesi kete palujtshmeri ta regjistroj ne emer te tije prane, Drejtoris per Gjeodezi, Kataser dhe Prone ne Mitrovice ne afat prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditesi ne padi si dhe ne seancat e mbajtura ka theksuar se palujtshmerin kontestuese i njeiti e ka blere nga shitesi ish nga ne vit. 1984 per qmim prej 4.000.000,00 Dinar dhe meniher ka ber pagesen e qmimit te kontraktuar duke hyr ne posedim te kesaj palujtshmerie dhe duke ndertuar ne te shtepin per banim e duke shfrytzu prej ateher gjermetani pa kurfar pengesash nga ana e askujt.

2.
Me rastin e blerjes paditesi ka qene i bindur qe shitesi i eshte pronare legjitim i saje dhe duke marr parasysh se kete te drejt ne posedim nuk ja ka kontestuar askush gjer me sot i njejti ka qene i bindur se shitesi ka qene edhe i regjistruar si pronar i kesaj palijtshmerie dhe para disa ditesh ka kuptuar se kjo pasuri ende po evidentohet ne emer te paditures.

Pasi qe e paditura eshte ne adrese te panjohr i propozoje gjykates qe te ia caktoje Perfaqsesin e perkohshem.

Ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe kerkespadine ta aprovoi si te bazuar sepse i njejti e ka fituar te drejten e pronesise ne baze te shitblerjes dhe mbajtjes me mirbesim mbi 20 vite.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Ne baze te propozimit te paditesit e konform nen 84 al.2 pika 4 si dhe nen 85 te LPK, gjykata me aktvendimin C. nr.30/2010 dt. 07.02.2013 te paditures i caktoi Perfaqsesin e perkohshem, Avokat nga Mitrovica.

Perfaqsesi i perkohshem i te paditurit ne pergjigje te padise dhe kerkespadise te paditesit deklaroi; qe lidhur me kete qeshtje te vendose ne pajtim me provat e shqyrtuara.

Shpenzimet e perocedures kontestimore nuk i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi;., Certifikaten mbi te drejtat pronesore UJ. 71208127 -00274-4 dt.11.03.2013, -Ekspertizen e ekspertit gjeodet ; Rushi Ujkani 08.03.2013, Kopjen e planit dt.11.03.2013, Faturat e KEK-Mitrovice te vit 1997, ne emer te paditesit, Procesverbalin mbi kqyrje ne vend te kesaj Gjykate C. Nr. 30/2010 dt.08.03.2013 si dhe ndegjoi deshmitaret ; Tahir Islami, Shefik Mehmeti si dhe ndegjoi paditesin ne cilsi te pales dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Certifikata mbi te drejtat e prones se palujtshme te cekur me larte , konstatohet se se parc kat. 00274-4, ZK- Shipol, evidentohet ne emer te paditures.

Nga konstatimi dhe mendimi i Ekspertit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; Ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon Drejtoria per Gjeodezi, Kataster dhe Prone ne Mitrovice , palujtshmeria tani lendore shtrihet dhe evidentohet ne parc kat. te cekur si ne dispozitiv.

Nga Kopja e planit e sipercekur, shifet; kultura ,vendi si dhe -siperfaqja e palujtshmerise tani lendore, parc.274-4.

Nga Proqesverbali mbi vendshiqim i kesaje gjykate i sipercekur, konstatohet se Gjyqtari me vrojtim te drejperdrejt ne vend konstaton se ne kete palujtshmeri tani lendore, gjendet shtepia perdhese e banuar nga paditesi dhe antaret e familjes se tije, garazha dhe se kjo palujtshmeri eshte e perkufizuar- rrethuar me mur nga blloka betoni dhe ka dyr te metalta te hyrjes.

Nga Fatura e . . . ne Mitrovicë e vit. 1997 konstatohet se paditesi ka qene shfrytzues i Energjis Elektrike ne shtepin e tije ne Shipol.

Deshmitari, . . . deklaroi; Une e dije qysh ne vit. 1984 paditesi nga i ka bler nje truall, 4- ari me qmim prej 4 -miljon Dinar per ari. Shitblerja eshte bere sipas marrveshjes gojore dhe ne tersi Mustafa e ka paguar qmimin e shitblerjes dhe menjeher shitesi i ka dorzuar kete truall ne posedim dhe shfrytzim te lire Mustafes i cili ka ndertuar shtepin perdhese ku edhe tani jeton me antaret e familjes.

Deshmitari, . . . deklaroi; Me i . . . njihen qe nga vitet e . . . dhe e dine qe ne vit . . . Mustafa nga shitesi . . . e ka bler nje truall rreth 4- ari. Ne kete truall menjeher ka ndertuar shtepine perdhese per banim ne te cilen jeton edhe tani dhe se gjermetani nuk e ka penguar askush ne shfrytzimin e ketije trualli.

Paditesi ne cilsa te pales deklaroi; palujtshmerin kontestuese e kame bler ne vit. . . nga shitesi . . . Ka bler 4- ari truall me qmim prej 16- . . . Ne tersi e ka paguar qmimin e shitblerjes dhe menjeher . . . ma ka dorzuar kete truall ne shfrytzim dhe po ate vit kame filluar ndertimin e shtepise dhe ne Vjesht kame hy ne te, ne te cilen jetoje edhe tani. Shitblerja eshte bere sipase marrveshjes gojore dhe i njeiti e ka dite se kjo eshte prone e . . . Mirepo tani vone ka kuptuear se kjo prone po u udhehiqte ne emer te paditures.. Nga momenti i shitblerjes gjermetani nuk ka pasur kurfar pengese nga askush ne shfrytzimin e kesaje palujtshmerie.. . . ka ndrruar jete para 3-4 viteve.

Ne nje gjendje te ktille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore paditesi e ka blere ne vit 1984 nga . . . ish nga Shipoli tani i ndjere , sipas Marrveshjes gojore me qmim te shitblerjes prej 16.000.000,00 . . . : te cilin qmim ne tersi ia ka paguar shitesit dhe menjeher ka hy ne shfrytzim te lire dhe te papengushem ne te cilen menjeher ka ndertuar shtepin perdhese per banim ne te cilen me te gjith antaret e familjes ka jetuar qe nga shitblerja e gjermetani

Ne nje gjendje te ktill faktike te vertetuar me larte, gjykata kerkespadin e paditesit e aprovoi ne tersi si te bazuar, konform nen 40 te Ligjit per pronsin dhe te drejttat te tjera sendore.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejttat te tjera sendore, Ligji nr. 03/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes , paditesi e ka ne shfrytzim dhe disponim te lire kete palujtshmeri dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimj i papengushem i kesaje palujtshmerive.

Mbajtja me mirbesim ekziston se kete palujtsheri paditesi e ka blere nga pronari faktik i saje duke qene i bindur se shitesi ka qene pronare legjitim i saje.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesi e ka blere kete palujtshmeri qysh ne vitin 1984.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie gjer me tani. Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit ne menyre -derivative me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C nr.30/2010 dt. 16.04.2013.

Gjyqtari,
Ragip Kadriu.

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine e permes kesaje gjykate.